



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 shkurt 2021
Nr. ref.:RK1713/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr.KI69/20

Parashtrues

Gjergj Nikolla

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit,
AC.nr.1461/15, të 14 shkurtit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Gjergj Nikolla, i përfaqësuar nga avokati Teki Bokshi nga Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [AC.nr.1461/15] e 14 shkurtit 2020 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktgjykimin [C.nr.143/14] e 19 shkurtit 2015 të Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 24 prill 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
7. Më 27 maj 2020, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që në Gjykatë të dorëzoi autorizimin përkatës.
8. Më 15 qershor 2020, përfaqësuesi i parashtruesit e dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësim.
9. Më 16 shtator 2020, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
10. Më 10 nëntor 2020, Gjykata i dërgoi një shkresë përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës dhe kërkoi disa dokumente shtesë si në vijim: (i) Aktvendimin [Ca. nr. 4881/2012] e 12 shkurtit 2014 të Gjykatës së Apelit; dhe (ii) Aktgjykimin [C. nr. 533/05] e 19 prillit 2012 të Gjykatës Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale).

11. Më 19 nëntor 2020, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës i dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.
12. Më 10 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Komunale kundër të paditurve, Komunës së Gjakovës dhe personit N.B., respektivisht. Parashtruesi i kërkesës kërkoi kompensimin e dëmit lidhur me veturën e vjedhur në parkingun e Komunës së Gjakovës. Personi i dytë i paditur, përkatësisht N.B., kishte punuar si rojtar i këtij parkingu.
14. Më 28 prill 2003, Gjykata Komunale përmes Aktgjykimit [P.nr.465/01], e shpalli fajtor personin N.B., për veprën penale të punës së papërgjegjshme në detyrë të përcaktuar përmes paragrafit 1 të nenit 213 të Ligjit Penal të Kosovës, duke e dënuar me dënim me kusht me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, ekzekutimi i të cilit shtyhet për dy (2) vite, me kusht që brenda kësaj periudhe të mos kryej vepër të re penale.
15. Më 19 prill 2012, Gjykata Komunale përmes Aktgjykimit [C.nr.533/15], i detyroi të paditurit, Komunën e Gjakovës dhe N.B.-në, respektivisht, që në mënyrë solidare në emër të kompensimit të dëmit, parashtruesit të kërkesës t'ia paguajnë shumën prej 2.629,00 euro, me kamatën përkatëse ligjore të cilën e paguajnë bankat komerciale në Kosovë, "*për mjetet e deponuara ne afat mbi një vit e pa destinim të caktuar*", duke filluar nga 10 shkurti 2011, përkatësisht data e kryerjes së ekspertizës, dhe deri në pagesën përfundimtare.
16. Në një datë të pasaktësuar, Komuna e Gjakovës, parashtrroi ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komunale, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje ose të ndryshohet dhe të refuzohet kërkesëpadija e parashtruesit të kërkesës.
17. Më 12 shkurt 2014, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [CA.nr.4881/2012] miratoi si të bazuar ankesën e Komunës së Gjakovës, dhe për pasojë e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, duke e kthyer çështjen në rivendosje.
18. Më 19 shkurt 2015, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.143/14] (i) duke u bazuar në nenet 136 (Bazat e përgjegjësisë) dhe 140 (Ekzistimi i fajësisë) të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejme: LMD) dhe nenet 154 (Bazat e përgjegjësisë) dhe 190 (Kompensimi i plotë) të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 (në tekstin e mëtejme: LMD e vjetër), në pikën I të dispozitivit miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës përkitazi me të paditurin e dytë, përkatësisht N.B., duke e detyruar të njëjtin që në emër të kompensimit të dëmit t'ia paguajë parashtruesit të kërkesës shumën prej 2.629,00 euro, shumë kjo e përcaktuar

përmes ekspertizës, me kamatën përkatëse ligjore të cilën e paguajnë bankat komerciale në Kosovë “për mjetet e deponuara në afat mbi një vit e pa destinim të caktuar”, duke filluar nga 10 shkurti 2011, përkatësisht data e kryerjes së ekspertizës dhe deri në pagesën përfundimtare; ndërsa (ii) në pikën II të dispozitivit refuzoi si të pathemeltë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës përkitazi me Komunën e Gjakovës.

19. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër pikës II të dispozitivit të Aktgjykimit [C.nr.143/14] të Gjykatës Themelore. Ankesë kundër këtij Aktgjykimi, kishte parashtruar edhe përfaqësuesi i të paditurit N.B.
20. Më 14 shkurt 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.1461/15] (i) aprovoi si të themeltë ankesën e përfaqësuesit të të paditurit N.B., duke ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në pikën I të dispozitivit, dhe rrjedhimisht duke e refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës në raport me të paditurin N.B.; dhe (ii) refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke vërtetuar pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Ac.nr.1461/15] e 14 shkurtit 2020 të Gjykatës së Apelit me pretendimin se i njëjti është nxjerrë në shkelje të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
22. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës, në esencë, thekson se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në shkelje të (i) nenit 154 të LMD-së sepse, në rrethanat e rastit konkret, përmes Aktgjykimit [P.nr.465/01] të 28 prillit 2003 të Gjykatës Komunale është vërtetuar fajësia e personit N.B., dhe rrjedhimisht ka ekzistuar “veprimi anti-juridik, lidhja kauzale dhe faji”, kushte këto kumulative siç janë përcaktuar në këtë nen; dhe (ii) nenin 14 [pa titull] të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), sepse “Gjykata civile është e lidhur me përgjegjësinë subjektive të kryesit të veprës penale të gjykuar me aktgjykimin penal”. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se “nuk ka kuptim fare arsyetimi i Gjykatës së shkallës së dytë, që asnjëri i paditur nuk mban përgjegjësi ligjore për shkaktimin e dëmit, i cili i është shkaktuar paditësit”, dhe për pasojë, gjykatat e rregullta nuk kanë siguruar një gjykim të drejtë dhe të paanshëm në rrethanat e tij.
23. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të neneve 3, 32 dhe 46 të Kushtetutës. Përkitazi me të parin, ndër tjerash, thekson se “është bërë aplikim i vrazhdë dhe i njëanshëm i ligjit material nga ana e gjykatës dhe me këtë është privilegjuar e paditura në dëme të paditësit”. Ndërsa përkitazi me të dytin dhe të tretin, përpos faktit që referohet në përmbajtjen e neneve 32 dhe 46, nuk arsyeton pretendimet e tij.

24. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesa e tij (i) të shpallet e pranueshme; (ii) të konstatohet se ka pasur shkelje të neneve 3, 31, 32 dhe 46 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së; (iii) të shpallet i pavlefshëm Aktgjykimi [Ac.nr.1461/15] i 14 shkurtit 2020 i Gjykatës së Apelit; dhe (iv) çështja të kthehet në rivendosje në Gjykatën Themelore.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

[...]

Kapitulli II Të Drejtat dhe Liritë Themelore

[...]

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Titulli I Të Drejtat dhe Liritë

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

**LIGJI Nr.29/78 MBI MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE I VITIT
1978**

**SHKAKTIMI I DËMIT
Nënpjesa 1**

**PARIMET E PËRGJITHSHME
Bazat e përgjegjesisë**

Neni 154

Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.

Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmi për ambientin përgjigjet pavarësisht nga faji.

Për dëmin pavarësisht nga faji përgjigjet edhe në raste të tjera të parashikuara me ligj.

LIGJ Nr.03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

P J E S A E P A R Ë

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME
KREU I**

**Neni 14
[pa titull]**

Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjesisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.

[...]

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

27. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

28. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Ac.nr.1461/15] e 14 shkurtit 2020 të Gjykatës së Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
29. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Më saktësisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

30. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm:

GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

31. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*. (Shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *“qartazi të pabazuar”*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *“qartazi të pabazuara”*, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 30 prillit 2020; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 275 deri më 304).
32. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
33. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton që rrethanat e rastit ndërlidhen me veturën e vjedhur të parashtruesit të kërkesës në parkingun e Komunës së Gjakovës, punëtor i së cilës ishte N.B. Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi për kompensim dëmi duke paditur Komunën e Gjakovës si dhe personin N.B. Ky i fundit, përkitazi me të njëjtën çështje, në vitin 2003 ishte shpallur fajtor për veprën penale të punës së papërgjegjshme në detyrë të përcaktuar përmes Ligjit Penal të Kosovës. Ndërsa, në vitin 2012, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit përkatës, kishte vendosur që Komuna e Gjakovës dhe N.B., në mënyrë solidare duhet të kompensojnë parashtruesin e kërkesës. Ky Aktgjykim megjithatë, ishte kthyer në rivendosje nga Gjykata e Apelit. Në procedurë të rivendosjes, Gjykata Themelore, kishte liruar Komunën e Gjakovës nga ky detyrim, ndërsa kishte përcaktuar personin N.B., si përgjegjës për kompensimin e dëmit. Duke vepruar sipas ankesave përkatëse, Gjykata e Apelit, kishte liruar nga ky detyrim edhe personin N.B., dhe kishte refuzuar për pasojë, të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës.
34. Parashtruesi i kërkesës e konteston konstatimin e Gjykatës së Apelit para Gjykatës, duke ngritur pretendime që ndërlidhen, në esencë, me garancitë

- procedurale të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me neni 6 të KEDNJ-së. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, vë theks në interpretimin e gabuar të (i) nenit 154 të LMD-së; dhe (i) nenit 14 të LPK-së, duke theksuar gjithashtu se “*nuk ka kuptim fare arsyetimi i Gjykatës së shkallës së dytë, që asnjëri nga të paditurit nuk mban përgjegjësi ligjore për shkaktimin e dëmit*”.
35. Në shqyrtimin e këtyre pretendimeve, Gjykata fillimisht thekson se të njëjtat në esencë ndërliidhen me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe zbatimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm nga Gjykata e Apelit, pretendime të cilat, Gjykata në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, i konsideron si “*pretendime të shkallës së katërt*”.
36. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, (shih, në këtë kontekst, sqarimin në Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2. “Shkalla e katërt”, paragrafët 281 dhe 288), parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të “*kushtetutshmërisë*” dhe “*ligjshmërisë*” dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI179/18, parashtrues *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).
37. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI49/19, cituar më lart, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 61).
38. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet

e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin përkatës. (Për një sqarim më të detajuar përkitazi me konceptin e “*aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*”, shih, ndër të tjera, Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së (aspekti civil), të 31 gushtit 2020, pjesën IV. Kriteret Procedurale; 3. Shkalla e Katërt; b. Fushëveprimi dhe Kufizimet e mbikëqyrjes së Gjykatës, paragrafët 329-333; dhe rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).

39. Në këtë kontest, Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës ndërlidhen me interpretimin e gabuar të nenit 154 të LMD-së dhe 14 të LPK-së nga ana e Gjykatës së Apelit. Në esencë, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta përgjatë zhvillimit të procedurës kontestimore janë të lidhura me përgjegjësinë penale të personit N.B., i cili është shpallur fajtor përmes Aktgjykimit [P.nr.465/01] të 28 prillit 2003 të Gjykatës Komunale, dhe se rrjedhimisht, i njëjti duhet të jetë përgjegjës edhe për kompensimin e dëmit ndaj parashtruesit të kërkesës në rrethanat e rastit konkret.
40. Gjykata megjithatë thekson se Gjykata e Apelit, kishte trajtuar çështjen e përgjegjësisë penale të personit N.B., dhe gjithashtu kishte shqyrtuar të dy nenet e lartcekura, nenin 154 të LMD-së dhe nenin 14 të LPK-së, respektivisht.
41. Për sa i përket të parit, përkatësisht aplikimit dhe interpretimit të nenit 154 të LMD-së, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ac.nr.1461/15] të 14 shkurtit 2020, ndër të tjera, kishte theksuar si në vijim:

“Përfundimi i gjykatës së shkallës së parë se nga provat e administruara është jo kontestuese se përgjegjës për dëmin e pësuar të paditësit, është i padituri i dytë sipas bazës së përgjegjësisë subjektive, duke theksuar se për të ekzistuar përgjegjësia subjektive duhet të plotësohen këto kushte: të shkaktohet dëmi, të ekzistoj veprimi anti juridik, të ekzistojë lidhja kauzale dhe të ekzistoj faji, duke vlerësuar se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet në mënyrë komulative dhe përgjegjësia e të paditurit të dytë rrjedh në bazë të nenit 154 të LMD-së (ligji i vjetër i cili ka qenë në fuqi kur ka ndodhur rasti). Ky përfundim i gjykatës së shkallës së parë është tërësisht i gabuar, paditësi por as gjykata gjatë administrimit të provave nuk kanë provuar faktin se ka pasur ndonjë raport juridik në mes të paditësit de të paditurit të dytë, ndonëse është kusht që të ekzistojnë subjektet e marrëdhënies detyrimore dhe të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar-shkaktuesi i dëmit dhe i dëmtuari, në rastin konkret mungon raporti juridik në mes të paditësit dhe të paditurit të dytë, i padituri i dytë nuk ka marrë përgjegjësi për ta ruajtur automjetin e paditësit të parkuar në parkingun e Komunës së Gjakovës, edhe pse i padituri i dytë ka qenë

punëtor me detyrë roje sigurimi, por fakti se ka qenë roje sigurimi nuk e bënë përgjegjës për pronën e personave të tretë, përveç nëse i padituri i dytë me veprimet e tij ka hyrë në detyrime në raport me personat e tretë në rastin konkret me paditësin. Paditësi nuk ka provuar faktin se i padituri i dytë ka marrë për obligim që të ruaj automjetin e tij, nuk është provuar fakti se paditësi automjetin e ka parkuar në parkingun e Komunës, me pëlqimin e të paditurit të dytë apo se ka pasur të drejtë dhe leje parkingu në parkingun e tipit të mbyllur, që në një rast të tillë do të krijonte edhe detyrimin për tu përgjigjur për dëmin eventual të paditurit të dytë, por edhe të paditurës së parë, por deri sa nuk është provuar ky fakt, nuk mund të detyrohet i padituri i dytë për kompensimin e dëmit të cilën paditësi e ka pësuar nga personat e tretë me vjedhjen e automjetit.”

42. Ndërsa, për sa i përket të dytit, përkatësisht aplikimit dhe interpretimit të nenit 14 të LPK-së, bazuar në të cilin, gjykata në procedurë kontestimore është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri, në këtë rast, personi N.B., është shpallur fajtor, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të saj, ndër të tjerash, kishte arsyetuar si në vijim:

“Fakti që i padituri i dytë është shpallur fajtor, me aktgjykimin P.nr.465/01 të datës 28.04.2003, për veprën penale të punës së pa ndërgjegjëshme në detyrë, dhe shpallja fajtor sipas kësaj vepre penale, do të ishte bazë për kompensimin e dëmit eventual të shkaktuar ndaj punëdhënësit, ndërsa nuk nënkupton të drejtën e paditësit që të kompensohet në raport me të paditurin e dytë, vetëm për faktin që është shpallur fajtor për këtë vepër penale, kjo e drejtë paditësit do i takonte vetëm nëse i padituri i dytë do të shpallej fajtor për veprën penale të vjedhjes së automjetit. Fakti se i padituri i dytë nuk i ka kryer detyrat e tij të punës, e bënë përgjegjës në raport me punëdhënësin, dhe është bazë për përgjegjësi disiplinore por edhe të kompensimit të dëmit eventual të pësuar nga punëdhënësi, por në asnjë rrethanë nuk mund të detyrohet ndaj personave të tretë, dhe as ndaj paditësit, deri sa nuk vërtetohet se paditësi ka vepruar me veprime konkrete në shkaktimin e dëmit, apo se në kuadër të detyrave të tij të punës ka qenë të ruaj edhe pronën e personave të tretë, pra duhet të plotësohet elementi subjektiv- fajësia e të paditurit të dytë në raport me paditësin në shkaktimin e dëmit, element që nuk ka mundur të vërtetohet as me shpalljen fajtorë me aktgjykimin P.nr.465/01 të datës 28.04.2003, për veprën penale të punës së pa ndërgjegjëshme në detyrë. Pra në rastin konkret mungon fajësia e të paditurit të dytë në shkaktimin e dëmit në vjedhjen e veturës, pasi vetura e vjedhur nuk është provuar se ka pasur leje parkingu në parkingun e mbyllur të komunës.”

43. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se Gjykata e Apelit, në rrethanat e rastit konkret, kishte trajtuar dhe arsyetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke përfshirë edhe ato që ndërlidhen me interpretimin e gabuar të dispozitave të LMD-së dhe të LPK-së, dhe se, në tërësinë e tyre, procedurat para Gjykatës së Apelit, nuk rezultojnë të kenë qenë të padrejta apo arbitrare.
44. Prandaj, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës

nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij se gjykatat e rregullta mund të kenë "*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*", duke rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin e kërkesës, dhe rrjedhimisht pretendimet e tij për interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm, kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e "*shkallës së katërt*" dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të "*ligjshmërisë*" dhe nuk janë argumentuar në nivel të "*kushtetutshmërisë*". Për pasojë, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

45. Në këtë drejtim, për t'i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtrueseve të kërkesës, Gjykata thekson se "*drejtësia*" që kërkohet përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi "*substanciale*", por drejtësi "*procedurale*". Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet përmes procedurës kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës. (Shih, KI131/19, parashtrues *Sylë Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 prillit 2020, paragrafi 57; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 55).
46. Kjo më saktësisht nënkupton, se palëve përgjatë një procedure të drejtë dhe të paanshme duhet të (i) u mundësohet zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; (ii) u akordohet mundësia që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsiderojnë relevante për rastin përkatës; (iii) u garantohet se të gjitha argumentet dhe dëshmitë, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit përkatës janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat përkatëse; (iv) u garantohet se faktet dhe pretendimet ligjore në vendimet gjyqësore ishin shqyrtuar dhe arsyetuar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, (v) u garantohet se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta dhe jo arbitrare. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 29; dhe KI131/19, cituar më lart, paragrafi 58). Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se ky nuk është rasti.
47. Gjykata gjithashtu rithekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI118/17 parashtrues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018, paragrafi 36; KI49/19, cituar më lart, paragrafi 54; dhe KI99/19, parashtruese *Persa Raičević*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48).
48. Gjykata, në fund, gjithashtu rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se në rrethanat e rastit konkret, Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit, është nxjerrë edhe në shkelje të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara përmes neneve 3, 32 e 46 të Kushtetutës. Gjykata në kontekst të këtyre pretendimeve, thekson se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të

dispozitive të lartcekura të Kushtetutës, pa argumentuar dhe arsyetuar shkeljen e pretenduara përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit.

49. Gjykata, në këtë aspekt, rikujton që ajo tashmë ka një praktikë shumë të konsoliduar përmes të cilës vazhdimisht ka theksuar se vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. (Shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës KIo2/18, parashtruese *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; dhe KI95/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31; dhe shih, gjithashtu Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 300 deri më 303).
50. Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës përtej referimit neneve të caktuara të Kushtetutës, nuk ka arsyetuar në mënyrë të qartë dhe adekuate se si mund të jenë cenuar këto nene përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit. Prandaj, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve të lartcekura të Kushtetutës, bien në kategorinë e pretendimeve "*të pambështetura apo paarsyetuara*". Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata, duke u bazuar në paragrafët (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, vazhdimisht ka theksuar se (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitive kushtetuese.
51. Në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata thekson se pretendimet e tij për shkelje të neneve 3, 32 dhe 46 të Kushtetutës, përbëjnë "*pretendime të pambështetura apo të paarsyetuara*", dhe si të tilla, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
52. Gjykata, në fund, gjithashtu thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
53. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 shkurt 2021, njëzëri:

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi